



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 12.03.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9.1 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës dhe Përfundimit nr.06- 16174-9/1 të miratuar me dt: 26.02.2015 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, me të cilin është miratuar kërkesa e OJQ “Gjakova”-Radio Gjakova për ndihmë financiare për realizimin e projektit “Transparenca Mediale e Komunës së Gjakovës në Valët e Radios”, me dt: 12.03.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e OJQ “Gjakova”-Radio Gjakova , e evidentuar me nr. 01-400-14698 e dt: 19.02.2015, për mbështetje financiare të këtij mediumi, për realizimin e projektit “Transparenca Mediale e Komunës së Gjakovës në Valët e Radios”, duke e ndihmuar me subvencione të Zyrës së Kryetares së Komunës në vlerë prej 6,000.00€ , për vitin kalendarik 2015 .

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 6,000.00€, nga mjetet e subvencioneve të Zyrës së Kryetares së Komunës dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirrollogarinë e OJQ “Gjakova” – Radio Gjakova në Gjakovë, nr. 1140015100000125 ProCredit Bank .

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

IV. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Kabinetit të Kryetares
- Z. Skender Gola, drejtor i OJQ ”Gjakova” –Radio Gjakova
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila